

VENDIM
Nr. 406, datë 13.5.2015

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit të Inovacionit, me vlerë të përgjithshme 40 000 000 (dyzet milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3 (tre) vjet, për periudhën 2015-2017. Fondi i krijuar fillon të zbatohet në vitin 2015 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- a) Për vitin 2015, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
- b) Për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.
- c) Për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Fondi i Inovacionit, përveç fondeve nga buxheti i shtetit të parashikuara si më sipër, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

3. Fondi i Inovacionit u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, deri në 400 000 (katërqind mijë) lekë. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, skema mbulon 50% të kostove të pranueshme dhe të miratuara, brenda kufirit të lartpërmendur. Përfitimi i ndërmarrjeve nga mbështetja e programeve apo projekteve për mbulimin e 50% të shpenzimeve të tjera të projektit, që nuk mbulohen nga Fondi i Inovacionit, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi i Inovacionit për të njëjtin projekt.

4. Në kostot e pranueshme, që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot për:

- a) auditim të kapacitetit inovativ dhe teknologjik që synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante vlerësimin për nivelin ekzistues të teknologjisë dhe mundësitë për rinovimin e tyre të inovacionit dhe/ose pozicionimit teknologjik, sipas një strukture konkurruese zhvillimi;
- b) ndërkombëtarizimin e teknologjisë, e cila synon t’u mundësojë ndërmarrjeve aplikante të identifikojnë dhe të inspektojnë teknologjinë që kërkojnë të përshtatin;
- c) pjesëmarrje në panaire inovacioni /tekno-logjie/RDI dhe të ngjashme;
- ç) promovim në lidhje me inovacione të ndërmarrjes;
- d) kostot e licencave (*software ose hardware*) ose patentave.

5. Përfitojnë nga Fondi i Inovacionit ndër-marrjet, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

- a) Janë biznese, të klasifikuara si mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, të ndryshuar.
- b) Kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- c) Prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit.

6. Pagesa e subvencionit bëhet 50% në fillim të projektit dhe 50% në fund të përfundimit të projektit, kundrejt faturës së shpenzimeve të kryera.

7. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit të Inovacionit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.

8. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e Fondit të

Inovacionit.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshihen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama